



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:115874

Datë: 09.11.2020

Numri i dokumentit: 01257017

P.nr.1840/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i çështjes Avni Sylja, me Bashkëpunëtoren profesionale Bleta Gashi-Rrusta, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. G., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.1497/2019 të datës 29.05/2019, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur me datë 28.10.2020, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Prokurorja e Shtetit Elza Bajrami dhe të akuzuarit A. G., më datë 30.10.2020 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 09.11.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.G., i biri Sh. dhe M. e gjinisë Sh., i lindur me dt.....në fshatin H., komuna e O. ku edhe banon, i martuar, baba i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, me gjendje të dobët ekomomike, me nr. personal, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja e të luajtshme që vetës ti sjellë përfitime pasurore të kundërligjshme, me datë 18.02.2019, rreth orës 20:23, në Obiliq, nga Shiriti, transportuese nga mihja sipërfaqësore ka marr dhe ka ngarkuar kamioneten e tij me qymyr dhe i njëjti është kapur me flagrancë nga ana e policisë.

-Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave dhe neneve 7, 17, 21, 41, 46, 49, 50, 51 dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Të akuzuarin A. G. me dënim me kusht duke i vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën verifikuese prej një (1) viti nuk kryen vepër tjetër penale, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 150€ (njëqind e pesëdhjetë euro) të cilin obligohet ta paguaj nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet nga i pandehuri, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 46 par 3 të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burgim, ku një ditë burgimi do të llogaritet me 20 (njëzet) euro, gjobë.

I pandehuri dënimin e shqiptuar mund të paguajë, me dy këste. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzetë Euro), të gjitha këto nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar lidhur me realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.1497/2019 të datës 29.05.2019, ka akuzuar A. G., për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 28.10.2020 dhe pas leximit të aktakuzës nga Prokurorja e Shtetit Elza Bajrami, pasi që i akuzuari A. G. është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPK-së, dhe pas njoftimit lidhur me pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, të pandehurit i është ofruar mundësia të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pa fajshëm, i akuzuari është deklaruar se e pranon fajësinë për aktakuzën që i vihet në barr nga Prokurorja e Shtetit duke shtuar se pendohet thell për veprën penale për te cilën akuzohet dhe këtë vepër e kam kryer pasi që i kam kushtet e vështira ekonomike materiale dhe jam detyruar që të siguroi thëngjillin për ngrohje në shiritat transportues në KEK, për çka më vjen keq dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale.

Prokurori i Shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, meqenëse pranimi fajësisë u bë u bë konform dispozitave ligjore që gjen mbështetjen në prova që jam bashkangjitur shkresave të lëndës .

Pasi që gjykata konstatoi që i akuzuari e pranoi në tërësi veprën penale me të cilën është ngarkuar, që i akuzuari e kuptoi natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, që pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, që pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 par.4 të KPRK-së, gjyqtari i vetëm gjykues mori aktvendim me të cilin e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që vlerësoi se ky pranim ishte në përputhje të plotë edhe me provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, e që të gjitha këto në mënyrë të plotë dhe të argumentuar e vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk administroi provat, por vazhdojë me matjen e dënimit.

Gjatë matjes së dënimit të akuzuarit, gjykata i vlerësoj të tëra rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe në lartësinë e dënimit konform nenit 73 të KPRK, andaj gjykata si rrethanë lehtësuese të akuzuarit i mori faktin e pranimit të fajësisë qysh në shqyrtimin fillestar, pendimin e thellë për veprën penale të kryer, gjendjen e vështirë materiale dhe faktin se është mbajtës i familjes, ndërsa rrethana rënduese për të akuzuarin nuk gjeti, andaj të akuzuarit konform nenit 50 dhe 51 të KPRK-së, për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i

shqipton dënim me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen veprë tjetër penale nga plotfuqishmërie e këtij aktgjykimi, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 150€ (njëqind e pesëdhjetë euro) të cilin obligohet ta paguaj nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me bindje se dënimet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe do të ndikojnë në risocializimin dhe riedukimin e tij si dhe do të ndikojë tek të tjerët që mos të kryejnë vepra penale çka është edhe qëllimi i shqiptimit të dënimit me kusht konform nenit 50 dhe dënim me gjobë konform nenit 46 të KPRK, dhe qëllimi i shqiptimit të dënimeve të përgjithshme i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6, lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1840/19 të datë 09.11.2020

Bashkëpunëtorja profesionale
Bleta Gashi Rrusta

G j y q t a r i
Avni Syla

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj gjykate.